



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**  
[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)  
[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.1**

**12 janar**

**2009**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM  
nr.1, datë 7.1.2009

Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve ..... 3

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”,**

**VENDIM**  
**Nr.1, datë 7.1.2009**

**PËR PAJISJEN, PËR HERË TË PARË, ME LETËRNJOFTIM, TË SHTETASVE SHQIPTARË  
DHE PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE E TË MASAVE SHTRËNGUESE, PËR ATA, QË NUK  
APLIKOJNË BRENDA KËTYRE AFATEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 3, pika 2 të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Aplikimi i shtetasve për t’u pajisur, për herë të parë, me letërnjoftim ose pasaportë elektronike, sipas kriterëve, mënyrës dhe vendit, të përcaktuara në ligjin nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e fondit shqiptaro-amerikan të ndërmarrjeve”, të fillojë më 12.1.2009.

2. Aplikimi për letërnjoftim dhe pasaportë elektronike kryhet në zyrat e regjistrimit, pranë bashkive/komunave/njërive bashkiake përkatëse, për personat, që kanë kryer në zyrat e postës ose në zyrat e financës të institucioneve përkatëse pagesën, të vërtetuar me mandatarkëtimin përkatës, për çdo dokument.

3. Të gjithë shtetasit mbi moshën 16 vjeç janë të detyruar të aplikojnë për t’u pajisur me letërnjoftim elektronik. Aplikimi për letërnjoftimin elektronik është i vlefshëm edhe për pajisjen me pasaportën e re elektronike.

4. Shtetasit, të cilët janë të detyruar të pajisen me letërnjoftim, sipas pikave 1 dhe 3 të këtij vendimi, dhe që janë në moshën mbi 18 vjeç në datën 28 qershor 2009, por nuk aplikojnë, nuk do të përfitojnë shërbimet e mëposhtme:

a) Pagesën ose shpërblimet për të gjithë personat fizikë, të punësuar në administratën dhe institucionet publike, si dhe për personat e punësuar në shoqëri, agjenci a ente shtetërore, qendrore apo vendore, nëse nuk kanë aplikuar deri më 25 shkurt 2009;

b) Pagesën apo shpërblimet për pensionistët, nëse nuk kanë aplikuar deri në 15 maj 2009;

c) Pagesën për ndihmë, përkrahje sociale apo çdo lloj ndihme tjetër, ofruar nga institucionet publike qendrore dhe vendore, nëse nuk kanë aplikuar deri më 30 prill 2009;

ç) Pranimin në provimet e fundvitit dhe regjistrimin në vitin shkollor/akademik pasardhës për të gjithë ata, që ndjekin studimet në shkollat e mesme dhe të larta, për pjesëmarrësit në konkurse apo gara të ndryshme, të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nëse nuk kanë aplikuar deri më 30 mars 2009;

d) Pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit;

dh) Shërbimin në zyrat e gjendjes civile;

e) Lëshimin ose rinovimin e lejeve, të autorizimeve, licencave nga organet e pushtetit qendror/vendor ndaj personave fizikë dhe përfaqësuesve ligjorë të personave juridikë;

ë) Lejimin për daljen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve emergjente;

f) Aplikimin dhe pajisjen me certifikatë pronësie nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

g) Aplikimin dhe lëshimin e dokumentit “Leje drejtimi automjeti” dhe kolaudimin e tyre;

gj) Lëshimin e vërtetimeve dhe të dokumenteve të tjera, të ngjashme me to, nga administrata gjyqësore;

- h) Shërbimet noteriale;
- i) Shpërndarjen e karburantit, pa akcizë, për fermerët;
- j) Shërbimin nga zyrat e Alba-Postës.

Për shërbimet e parashikuara në shkronjat “d” deri “j”, afatet fillojnë të zbatohen nga data 1 shkurt 2009.

5. Rekomandohet Banka e Shqipërisë të miratojë akte nënligjore, të detyrueshme për të gjithë ofruesit e shërbimeve bankare dhe financiare, në Republikën e Shqipërisë, me anë të të cilave detyrohen këta shtetas, që, pas datës 15 prill 2009, të paraqesin, pranë shërbimit bankar, dokumentin e identitetit ose kopje të formularit të aplikimit.

6. Udhëzohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, që të miratojë akte nënligjore, të detyrueshme për ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik (duke përfshirë shërbimet radiotelevizive) dhe shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm (të palëvizshëm), të lëvizshëm, tokësor dhe jotokësor, me anën e të cilave detyrohen këta shtetas, që, pas datës 30 prill, të paraqesin pranë këtyre autoriteteve letërnjoftimin ose kopje të formularit të aplikimit për pajisje me letërnjoftim.

7. Në çdo rast, ofruesit e shërbimeve, të përmendura në pikën 4 të këtij vendimi, duhet të shënojnë në dokumente numrin personal të identitetit ose numrin e aplikimit, që ndodhet në formularin e aplikimit. Në mungesë të këtyre numrave, ofrimi i shërbimit nga punonjësit përben kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e masa të tjera administrative.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, u dërgon, jo më vonë se data 31 janar 2009, të gjitha bashkive/komunave/njësi bashkiake, listën përkatëse të shtetasve me të drejtë vote, që nuk janë të pajisur me pasaportë. Njësia përkatëse e bën listën publike dhe njofton shtetasit, emrat e të cilëve janë të shënuar në listë, për të aplikuar me përparësi për letërnjoftim.

9. Të gjitha institucionet shtetërore, qendrore apo vendore, marrin masa që pagesa për aplikimin për letërnjoftim për punonjësit e tyre të kryhet brenda institucioneve përkatëse. Kjo pagesë mund të përfshijë edhe pagesat për familjarët e personave të punësuar në institucionet shtetërore.

10. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë udhëzimin për formën e përmbajtjen e dokumenteve standarde për pagesën dhe aplikimin për pajisje me letërnjoftim dhe pasaportë elektronike, si dhe të marrë masat e duhura administrative për bashkërendimin e veprimtarive me të gjitha institucionet publike për zbatimin e këtij vendimi, e për fushatën publicitare, për nxitjen e shtetasve për pajisjen me letërnjoftim dhe pasaportë elektronike.

11. Vendimi nr.596, datë 7.9.2006 i Këshillit të Ministrave “Për përdorimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të identitetit të shtetasve nga organet e administratës publike”, dhe çdo akt tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

12. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Financave, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Brendshëm dhe Banka e Shqipërisë, si dhe të gjitha institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe ministrave ose Këshillit të Ministrave, që ofrojnë shërbime, të nxjerrin akte nënligjore, sipas fushave dhe në përputhje me ligjet përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 12.1.2009  
Doli nga shtypi më 12.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2009

Çmimi 4 lekë